



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, STREHIMIT DHE SHËNDETIT PUBLIK

Lënda: Kthim përgjigje në lidhje me kërkesën tuaj për informacion

E nderuar,

1-Gjatë 3 viteve sa familje kanë përfituar kredi të butë?

Në total janë miratuar 145 përfitues si dhe 33 përfitues në listën rezerve të miratuar me disa vendime të keshillit bashkiak.

Këto përfitues janë në proces të verifikimit dhe kontraktimit me institucionin financiar zbatues të programit.

2-Cilat janë kriteret për të përfituar kredi të butë?

Kur programi financohet nga buxheti i shtetit, njesite e veteqeverisjes vendore, brenda kuotave të percaktuara paraprakisht nga ministria përgjegjëse për strehimin (numrit të familjeve që përfitojnë), miratojnë listën e familjeve sipas sistemit të pikezimit të miratuar prej tyre dhe që plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) Kane të ardhura mujore jo më të larta se të ardhurat mesatare të njesise së veteqeverisjes vendore përkatëse dhe nuk përballojnë dot pagesat e kredive për blerjen e një banese me vlerë jo më të madhe se mesatarja e vlerave të tregut në atë njesi dhe me sipërfaqe jo më të madhe se normat e strehimit; b) Nuk disponojnë banesë në pronësi ose disponojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit, apo janë zhvendosur nga banesat, sipas parashikimeve të nenit 6, të ligjit

nr.22/2018.

3-Sa herë në vit hapen aplikimet dhe sa zgjat?

Aplikimet hapen zakonisht një herë në vit në varësi të burimeve financiare apo kuotave që vë në dispozicion ministria përkatëse. Por gjithashtu gjatë gjithë vitit pranë shërbimit të Zyres me 1 Ndalës të bashkisë specialisti i strehimit ofron shërbim 5 ditë në javë, informacion, këshillim dhe lehtësim për personat dhe familjet në nevojë.

4-Për vitin 2020 sa familje kanë aplikuar dhe sa prej tyre kanë përfituar nga kredite e buta?

Gjatë vitit 2020 kanë aplikuar 105 qytetarë dhe janë miratuar si përfitues në këtë program 104 përfitues.

5- Po për vitin 2021 sa familje kanë aplikuar dhe sa prej tyre ka përfituar nga kredite e buta?

Për vitin 2021 janë 91 përfitues nga të cilët 42 janë miratuar si përfitues në listën parësore dhe 33 në listën rezervë, në rastin kur përfituesit nuk kualifikohen nga institucioni financiar.

6-Për vitin 2020 sa persona me aftësi ndryshe apo kujdestare për një person me probleme shëndetësore, kanë përfituar nga skema?

Për vitin 2020, nga lista e përfituesve 12 aplikues i përkasin kategorisë së PAN.

7-Sa nga çiftet të divorcuara për vitin 2020 dhe 2021 kanë përfituar nga skema e kredive të buta?

Gjatë vitit 2020 dhe 2021, janë 37 përfitues që i përkasin kategorisë së “çifte të reja”.

Sqarojmë që çiftet të divorcuara, nuk janë kategori e njohur nga ligji si kategori përfituese të programeve të strehimit social.

8-Sa prej grave të dhunuara kanë përfituar nga skema e kredive të buta?

Nga instrumenti financiar “Subvendicionimi i interesave të kredisë” në zbatim të Programit “Banesa me kosto të ulët”, janë përfitues 3 gra që i përkasin kategorisë “gra të dhunuara”.

9-Në rast se përfituesi nuk plotëson pagesën ose 20% të vlerës së apartamentit, çfarë ndodh me kredinë e fituar?

Përfituesi është në marrëdhënie kontraktuale me institucionin financiar që i mundëson kredinë me interesa të lehtësuara nga shteti. Në rast të se nuk plotëson pagesën e 20% të vlerës së kredisë, priset kontrata dhe fondi i përcaktuar për këtë përfitues kalon tek përfituesi i radhës në listën rezervë.

10-A janë konstatuar persona që kanë mashtruar me deklaratimet e tyre për të përfituar kredinë e butë dhe sa raste ka ndodhur? Si vepohet me ata?

Kundrejt personave që bëjnë deklaratime të rreme vepohet në bazë parashikimeve të legjislacionit shqiptar. Në rast të konstatimit të deklaratimeve të rreme, aplikuesit dhe anëtarëve të familjes i hiqet e drejta për të përfituar nga programet e strehimit. Aplikuesit dorëzojnë “Deklaratë e vërtetësisë së informacionit paraprak”, shtojca “B”. e VKM.

11-Në rast se kreditë e buta bllokohen sic ka ndodhur një herë para disa vitesh në Bashkinë Tiranë për shkak se kishte dyshime për përfitime të paligjshme nga kredia, si vepohet, lajmërohet përfituesit, çfarë bëhet konkretisht?

Të gjitha rastet vlerësohen individualisht dhe vepohet siç është e shprehur mësipër në zbatim të detyrimeve ligjore.

